

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6487  
E shtunë, 11 dhjetor 2021  
çmimi 0.40 €

Osmani: Kosova  
beson në vlerat e  
OKB-së FAQE 3



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

SERBIA NUK I NDAL PROVOKIMET PËR MOHIM TË MASAKRAVE TË KRYERA NË KOSOVË FAQE 4-5

## BE-ja: SERBIA NUK MUND TA MOHOJË MASAKRËN E REÇAKUT



Shteti i Serbisë nuk i ka ndalur pretendimet për t'i mohuar masakrat e kryera në Kosovë. Ministri i Punëve të Brendshme i Serbisë, Aleksandër Vulin, sërish të premtën ka tentuar ta mohojë

masakrën e Reçakut, duke thënë se ajo është "masakër e supozuar". Ndaj këtyre pretendimeve ka reaguar Bashkimi Evropian (BE), duke thënë se kjo masakër është e

dokumentuar mirë dhe nuk mund të mohohet nga askush. Zëdhënësi i BE-së për politikë të jashtme, Peter Stano, ka thënë se mohimi i kësaj masakre është kundër vlerave evropiane f

KOSOVA SHËNON DITËN NDËRKOMBËTARE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT



## S'KA MARRËVESHJE ME SERBINË PA U ZGJIDHUR ÇËSHTJA E TË ZHDUKURVË ME DHUNË

FAQE 5

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
E-mail: [renova@ml.net.mk](mailto:renova@ml.net.mk)  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

### AKTUALE



TOTAJ: PO JETËSOJMË DËSHIRËN E MADHE TË THAÇIT DHE TË VESELIT F. 6

ANËTARI I OVL-UÇK-SË: KEMI DASHUR T'I TREGOJMË PUBLIKUT SE SERBIA I KA DHËNË INFORMATA SPECIALES F. 3

PROFESORËT DHE MJEKËT NË KATEGORINË E ZYRTARËVE PUBLIKË, OBLIGOHEN TA DEKLAROJNË PASURINË F. 7

GJERMANIA KËRKON ANGAZHIMIN E KOSOVËS DHE TË SERBISË NË NEGOCIATA F. 3

### EKONOMI



MURATI NËNSHKRUAN MARRËVESHJE MILIONËSHE ME DY INSTITUCIONE BANKARE EVROPIANE F. 8

PROTESTOJNË PUNËTORËT E KEK-ut, KËRKOJNË PAGËN E 13 F. 8

OAK-U KËRKON SHKURTIMIN E AFATIT KOHOR PËR INICIMIN E PROCEDURËS HETIMORE NË AKK F. 8

### SPORT

NUHIU DHE KRASNIOI: EDHE NDAJ ULPIANËS I PRESIM TRI PIKË F. 10



## ShBA-ja fiton rastin në Britani për ekstradimin e Julian Assange

Londër, 10 dhjetor - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) e kanë fituar rastin në Gjykatën e Lartë të Londrës për ekstradimin e themeluesit të faqes "WikiLeaks", Julian Assange, për t'u përballur me akuza kriminale, përfshirë shkeljen e një ligji të spiunazhit dhe kompletimin e hakimit të kompjuterëve qeveritarë. "Gjykata e lejon

ankesën, - ka thënë gjykatësi Timothy Holroyde, duke shtuar se - Shtetet e Bashkuara i kanë ofruar një pako të garancisë Britanisë rreth ndalimit të Assanges", shkruan "Reuters".

Shtetet e Bashkuara e akuzojnë australianin për 18 raste rreth publikimeve të një numri të madh të dokumenteve konfidenciale

ushtarake dhe kabllove diplomatike, për të cilat thonë se e kanë rrezikuar jetën e njerëzve.

ShBA-ja kishte paraqitur ankesë kundër një vendimi të Gjykatës së Qarkut të Londrës më 4 janar, sipas të cilit, Assange nuk duhet të ekstradohet në Shtetet e Bashkuara, sepse ka gjasë që të kryejë vetëvrasje në një burg amerikan.



## Bideni e siguron Ukrainën për mbështetjen amerikane



UASHINGTON, 10 DHJETOR - Presidenti amerikan Joe Biden i ka thënë homologut të tij ukrainas, Volodymyr Zelenskiy, se Shtetet e Bashkuara e mbështetin plotësisht sovranitetin e Ukrainës, teksa ushtria ruse është grumbulluar në afërsi të kufirit ukrainas. Bideni ka "rikonfirmuar përkushtimin e palëkundur për sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës", ka njoftuar Shtëpia e Bardhë, pasi dy presidentët kanë zhvilluar një bisedë telefonike që ka zgjatuar rreth 90 minuta. Presidenti Biden, po ashtu, "e

bëri të qartë se ShBA-ja dhe aleatët e partnerët e saj janë të përkushtuar në parimin që nuk do të ndërmerren vendime dhe diskutime për Ukrainën pa përfshirjen e Ukrainës", është thënë në deklaratë.

Ai, po ashtu, ka ripërsëritur qëndrimin se ShBA-ja dhe aleatët e saj do të vendosin sanksione ekonomike ndaj Rusisë dhe do ta rritin ndihmën për Ukrainën nëse Rusia pushton Ukrainën, ka thënë Shtëpia e Bardhë.

Bideni, po ashtu, ka biseduar me liderët e nëntë shteteve në Evropën Lindore, që janë

anëtare të NATO-s, me të cilët ka biseduar për grumbullimin e ushtrisë ruse në kufi me Ukrainën.

Në takimin virtual ndërmjet Bidenit dhe presidentit rus, Vladimir Putin, më 7 dhjetor, dy liderët kishin diskutuar për situatën në Ukrainë.

Bideni kishte paralajmëruar Moskën se mund të përballlet me "sanksione të rënda ekonomike" nëse trupat ruse sulmojnë Ukrainën.

Rusia mohon se po planifikon që ta sulmojë Ukrainën dhe Moska po kërkon garanci kundër zgjerimit të NATO-s në lindje.

## Të paktën 54 të vdekur pas rrokullisjes së kamionit në Meksikë

MEKSIKO-CITY, 10 DHJETOR - Të paktën 54 persona kanë vdekur dhe dhjetëra të tjerë janë lënduar, pasi kamioni me të cilin po udhëtonin, u aksidentua në jug të Meksikës, kanë njoftuar autoritetet.

Mbi 150 persona, që është thënë se janë emigrantë nga Amerika Qendrore, ishin në rimorkion e kamionit, kur ai është rrokullisur në shtetin Chiapas.

Ky është një prej aksidenteve më të rënda të këtij lloji në Meksikë. Dyzet e nëntë viktimat janë konfirmuar të vdekur në vendin e ngjarjes, ndërkaq pesë të tjerë kanë vdekur në spital, ka thënë guvernatori i Chiapas, Rutilio

Escandon.

"Afër 105 persona, 83 burra dhe 22 gra, janë lënduar gjatë këtij aksidenti", ka thënë ai.

Kombësia e viktimave nuk është konfirmuar ende, por zyrtarët lokalë kanë thënë se shumica e personave që po udhëtonin me këtë kamion transportues, ishin nga Honduras dhe Guatemala. Presidenti i Meksikës, Andres Manuel Lopez Obrador, e ka përshkruar këtë aksident si "shumë të dhimbshëm" dhe ka shtuar se "më vjen shumë keq për tragjedinë" e ndodhur.

Kamioni raportohet se ishte duke ecur me shpejtësi kur shoferi ka bërë një kthesë të



mprehtë, duke goditur një urë për këmbësor në Tuxla Guiterrez në shtetin Chiapas.

Shteti mexikan Chiapas, që gjendet në afërsi të Guatemalës, është pika e transitit për emigrantët. Qindra mijëra

migrantë, që ikin për shkak të varfërisë dhe dhunës në Amerikën Qendrore, çdo vit tentojnë që të kalojnë nëpër Meksikë me qëllim që të arrijnë në Shtetet e Bashkuara.

Shumica paguajnë

kontrabandistë, të cilët më pas i transportojnë ata me kamionë të mbushur plot me emigrantë.

Kufiri ShBA - Meksikë është një prej kufijve më të rrezikshëm, ka thënë

Organizata Ndërkombëtare për Migrim. Vetëm gjatë këtij viti, të paktën 650 persona kanë vdekur teksa kanë tentuar që ta kalojnë kufirin, që është shifra më e lartë e viktimave e regjistruar ndonjëherë.

Organizata Ndërkombëtare për Migrim tha se ka pasur edhe vdekje të tjera gjatë rrugëtimit të emigrantëve drejt kufirit, megjithatë kjo organizatë tha se këto raste është vështirë që të dokumentohen.

## Macroni: Në rast të krizës të sakrifikohet zona e Shengenit

PARIS, 10 DHJETOR - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka folur për një mekanizëm të ri për mbrojtjen e kufijve të jashtëm të Evropës. Në rast krize, ai ka thënë se do të sakrifikohet edhe zona e Shengenit. I mundur është edhe dërgimi i forcave të sigurisë dhe materialeve nga

shtetet e tjera anëtare, ka thënë Macroni.

Më tutje, Macroni ka kërkuar edhe kontrollimin politik të zonës së Shengenit sipas modelit të eurozonës. Sipas tij, duhet të ketë raunde të rregullta takimi të ministrave, që mund të vendosin për një forcim të kontrolleve të kufijve.

"Një Evropë sovranë është për mua një Evropë që i ka nën kontroll kufijtë e saj", është shprehur Macroni në një konferencë për media.

Ai i është referuar situatës në kufirin e Polonisë me Bjellorusinë, si dhe në Kanalin e La Manshit, ku është duke "sunduar" një gjendje

dramatike e refugjatëve dhe konflikte me vendet fqinje. "Deri më tani reagimet tona kanë ardhur shumë vonë, kur një nga partnerët tanë është lutur për ndihmë", ka thënë presidenti francez. Gjatë presidencës franceze Macroni ka kërkuar të shënohet përparim në paktin evropian të



migracionit, që parashikon një ndarje më të drejtë të refugjatëve në Evropë.



## Murati: Do të jemi në presion të jashtëzakonshëm për dialogun me Serbinë

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, ka vlerësuar se Kosova do të jetë në presion të madh ndërkombëtar për dialogun me Serbinë. Ai ka thënë se ky presion do të jetë për zbatimin e marrëveshjes së

Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. "Kryeministri Kurti ka ardhur në pushtet duke refuzuar të gjitha proceset në të cilat ka qenë Kosova dhe shpeshherë kritikën e tij kanë qenë edhe të drejta, por ai asnjëherë nuk ka dhënë zgjidhje se cila

është rruga dalëse. Të gjitha palët nuk po japin zgjidhje për gjendjen në të cilën gjendet Kosova. Ne do të jemi në presion të jashtëzakonshëm sa i përket dialogut, zbatimit të asociacionit dhe e keqja e kësaj është se cilën rrugë do ta marrim për t'i zgjidhur

problemet me Serbinë dhe si do t'u përgjigjemi aleatëve tanë, BE-së dhe ShBA-së. Janë çështje komplekse të cilat mund të na kushtojnë me një status-quo të gjatë që do të jetë dërrmuese për Kosovën", ka deklaruar ai për "EO".



## Anëtari i OVL-UÇK-së: Kemi dashur t'i tregojmë publikut se Serbia i ka dhënë informata Speciales

HAGË, 10 DHJETOR - Në Dhomat e Specializuara në Hagë ka dëshmuar të premten dëshmitari i mbrojtjes, Qelë Gashi, i cili është anëtar i Këshillit Drejtues të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së. Në seancën gjyqësore ndaj Hysni Gacatit dhe Nasim Haradinajt, ai ka thënë se në paketat që kishin arritur në OVL-UÇK kishte dokumente në gjuhën serbe dhe emra serbë, ndër të cilët edhe Vukoviqi. Gashi ka deklaruar se me publikimin e tyre kanë synuar ta informojnë publikun që Serbia po i jep informata Gjykatës Speciale.

Në deklaratën e tij me shkrim, të cilin e ka lexuar mbrojtja, Gashi ka thënë se më 7 shtator ka qenë bashkë me Hysni Gucatin, Nasim Haradinajn dhe Faton Klinkun në zyrën qendrore të OVL-UÇK në Prishtinë kur rreth orës 10:00 dikush kishte sjellë paketa me dokumente. "Skena ishte shumë hetuese, disa thoshin që paketa kishte bombë dhe kjo shkaktonte panik. Megjithatë, kur Nasimi shkoi të shikonte, ne e kuptuam që në paketë kishte vetëm letra. Sapo u kuptua një gjë e tillë,

situata u qetësua", ka thënë ai në deklaratën e tij me shkrim.

Ai ka thënë se i ka shikuar pjesërisht dokumentet dhe ka parë që shumë prej tyre ishin në gjuhën serbe dhe përmbanin emra serbë. "Këto dokumente kishin shkrim në gjuhën serbe, përfshirë emra serbë si Vukoviq. Nuk e njihja këtë emër, megjithatë e kam parë këtë emër shumë herë sepse ishte përmendur në shumë dokumente", ka thënë Gashi. Sipas Gashit, publiku në Kosovë duhej të informohej lidhur me përmbajtjen e paketave që nga një person i panjohur ishin dërguar në OVL-UÇK. "Duke shikuar paketën me dokumente mendova me vetvete se si ka mundur ZPS të bie në nivelin e Serbisë. Isha i hutuar lidhur me qëllimin e arsyes pse ishin sjell dokumentet. Ne menduam që publiku i Kosovës duhet të informohej lidhur me përmbajtjen e paketës meqë kjo do t'i minonte Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK) i cili është organ që ne nuk e njohim si legjitim. Ne nuk kemi



dashur të japim emra vetëm kemi dashur t'i tregojmë publikut që Serbia i ka dhënë informata Hagës", ka thënë Gashi në deklaratën e tij me shkrim. Gashi ka thënë se nuk i ka lexuar të gjitha dokumentet që kishin

arritur më 7 shtator në OVL-UÇK meqë, sipas tij, numri i tyre ishte i madh.

Dëshmia e Qelë Gashit vjen pasi të enjten në Dhomat e Specializuara janë dëgjuar katër dëshmitarë të mbrojtjes në

gjyqin ndaj ish-krerëve të OVL-UÇK-së.

Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj u arrestuan më 25 shtator 2020 prej kur edhe po qëndrojnë në paraburgim në Hagë.

## Osmani: Kosova beson në vlerat e OKB-së



PRISHTINË, 10 DHJETOR (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të premten në takim ndihmësekretaren e përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe ndihmësadministratoren e UNDP-së, Mirjana Spoljaric-Egger, të cilën e ka falënderuar për mbështetjen që kjo organizatë i ka dhënë Kosovës që nga viti 1999. Sipas presidentes Osmani, me këtë mbështetje UNDP-ja ka kontribuar në rritjen e perspektivës së zhvillimit në vend dhe në këtë kontekst ka përmendur se pandemia ka

goditur shumë biznese të udhëhequra nga gratë. Ajo ka theksuar nevojën e përfshirjes më të madhe të grave në tregun e punës për ta realizuar potencialin e plotë për zhvillim ekonomik të një vendi. Presidentja Osmani ka theksuar se Kosova beson në vlerat e OKB-së dhe vizionin e saj për zhvillim të qëndrueshëm.

Më tutje, presidentja Osmani ka theksuar se për një zhvillim të qëndrueshëm duhet të investohet në kapitalin njerëzor. Sipas saj, objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm përfaqësojnë një

udhërrëfyes për një mirëqenie më të mirë.

Të dy bashkëbisedueset kanë folur edhe për transformimin digjital, tranzicionin në energjinë e gjelbër dhe financimin inovativ. Në këtë drejtim, presidentja Osmani ka theksuar nevojën për financim të konsiderueshëm për ta realizuar tranzicionin e drejtë energjetik në Kosovë, i cili ka në konsideratë shtimin e kapaciteteve prodhuese nga burimet e ripërtërishme të energjisë dhe koston e përballeshme të energjisë për qytetarët.

## Gjermania kërkon angazhimin e Kosovës dhe të Serbisë në negociata

Berlin, 10 dhjetor - Sekretari i shtetit për Punë të Jashtme i Gjermanisë, Miguel Berger, ka takuar emisarin e BE-së për

dialog Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, të cilit i ka dhënë mbështetjen e Gjermanisë në këtë proces. Në llogarinë e vet në

"Twitter", Bergeri ka shkruar se si Kosova ashtu edhe Serbia duhet të angazhohen në mënyrë konstruktive në këtë proces. "Si

Kosova ashtu edhe Serbia tani duhet të angazhohen në mënyrë konstruktive në negociata", ka shkruar Bergeri.







SERBIA NUK I NDAL PROVOKIMET PËR MOHIM TË MASAKRAVE TË KRYERA NË KOSOVË

# BE-ja: Serbia nuk mund ta mohojë masakrën e Reçakut

Shteti i Serbisë nuk i ka ndaluar pretendimet për t'i mohuar masakrat e kryera në Kosovë. Ministri i Brendshëm i Serbisë, Aleksandër Vulin, sërish të premten ka tentuar ta mohojë masakrën e Reçakut, duke thënë se ajo është "masakër e supozuar". Ndaj këtyre pretendimeve ka reaguar Bashkimi Evropian (BE), duke thënë se kjo masakër është e dokumentuar mirë dhe nuk mund të mohohet nga askush. Zëdhënësi i BE-së për politikë të jashtme, Peter Stano, ka thënë se mohimi i kësaj masakre është kundër vlerave evropiane

vend për të mohuar apo për ta nënvlerësuar atë që ka ndodhur në Reçak. "Rajoni ka nevojë për pajtim, stabilitet dhe normalizim të marrëdhënieve. E ritheksojmë se nuk ka vend për të mohuar apo për ta nënvlerësuar atë që ndodhi në Reçak", ka thënë Stano.

Pretendimin e Vulinut e ka dënuar edhe ish-ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli. Ai ka vlerësuar se kjo masakër ishte e planifikuar nga shteti serb dhe është udhëhequr nga shefi i njësiteve speciale, Goran Radosavljeviq-Guri. "E lexova një deklaratë të Aleksandër Vulinut, i cili nëpërmjet filmave propagandistikë përpiqet ta gënjejë botën. Krimin që ndodhi para syve të gjithë botës demokratike dhe i cili provokoi bombardimet e NATO-s ndaj regjimit më të tmerrshëm që ka njohur

Evropa. Si një nga ata që ka njohuri të madhe për atë se si është organizuar dhe si ka ndodhur masakra e Reçakut nga shteti serb, do të vazhdoj të angazhohem maksimalisht, bashkë me miqtë dhe bashkëpunëtorët e mi, për prezantimin e të vërtetës deri në nxjerrjen para drejtësisë të secilit kriminel", ka shkruar Pacolli në profilin e vet në "Facebook".

Sipas tij, ky është veprim i turpshëm i ministrit serb të Mbrojtjes. "Masakra e Reçakut është planifikuar dhe organizuar nga shteti serb dhe është udhëhequr nga shefi i njësiteve speciale Goran Radosavljeviq-Guri. Ambasadori Walker dhe bota e civilizuar janë dëshmitarët e së vërtetës! Është turp, për ty Vulin dhe të gjithë ata që prekin në plagët e pashëruara!", ka shkruar Pacolli.

Ministri i Punëve të

Brendshme i Serbisë, Aleksandër Vulin, ka thënë se ky krim i tmerrshëm ishte "një gënjeshtëri e madhe dhe një falsifikim i tmerrshëm". Gjatë një vizite që ai i ka bërë lokacionit në rrethinën e Nishit, ku është realizuar filmi për ngjarjet në atë fshat në janar të vitit 1999, Vulin e ka quajtur masakrën e Reçakut si "një fyerje e madhe për mbarë njerëzimin". "Agresioni i NATO-s filloi pas një gënjeshtre të tmerrshme për Reçakun. Në atë kohë ne nuk ishim as të aftë dhe as të zgjuar për t'i treguar gjithë botës se çfarë gënjeshtre e tmerrshme ishte. Detyra e këtij brezi është t'i tregojë gjithë botës se na bombarduan dhe na bënë kriminelë falë gënjeshtres dhe se gjaku i fëmijëve tanë është mbi ata që e shpikën këtë gënjeshtëri", ka thënë Vulin.

Ministria e Punëve të Brendshme dhe

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 10 DHJETOR** - Ministri i Brendshëm i Serbisë, Aleksandër Vulin, sërish ka tentuar ta mohojë masakrën e Reçakut. Deklarimi i zyrtarit serb, se kjo masakër është një gënjeshtëri, ka nxitur reagimin e Bashkimit Evropian (BE) dhe të spektrit politik të Kosovës. Zëdhënësi i BE-së për politikë të jashtme, Peter Stano, ka

deklaruar se kjo masakër është dokumentuar mirë dhe nuk mund të mohohet nga askush. "Ajo që ndodhi në Reçak të Kosovës dhe mizoritë e kryera atje në janar 1999 janë të dokumentuara mirë. Mohimi është në kundërshtim me vlerat e Bashkimit Evropian dhe në kundërshtim me projektin e integritetit të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian", ka thënë ai për medie. Sipas tij, nuk ka



KOSOVA SHËNON DITËN NDËRKOMBËTARE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

# S'ka marrëveshje me Serbinë pa u zgjidhur çështja e të zhdukurve me dhunë

Republika e Kosovës të premten ka shënuar Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut. Në këtë ditë Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur ka paraqitur punën njëvjeçare e cila ndërlidhet me procesin e zbardhjes të fatit të të pagjeturve, ndërsa kryeministri Albin Kurti ka bërë me dije se nuk do të ketë marrëveshje me Serbinë pa u zgjidhur çështja e të zhdukurve. Në anën tjetër, kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka kërkuar nga institucionet që të përkushtohen çdo ditë për avancimin e të drejtave të njeriut

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 10 DHJETOR** - Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, të premten ka shënuar Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut. Në këtë aktivitet ka marrë pjesë edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Me këtë rast, Kurti ka thënë se ka respektuar kërkesën e familjarëve për t'iu qasur çështjes së të zhdukurve me seriozitet të plotë, duke ushtruar ndikimin te mekanizmat vendorë dhe ndërkombëtarë. "Unë besoj që e keni përcjellë edhe ju që personalisht kam qenë tejet i zëshëm dhe në secilin takim publik e jopublik me aktorët relevantë ndërkombëtarë e kam ngritur çështjen e personave të zhdukur me dhunë si çështje edhe me prioritet dhe urgjencë", ka thënë Kurti.

Ai ka thënë se për të si kryeministër dhe për Qeverinë e Kosovës është më shumë rëndësi që prioritetet t'i kenë të qarta. "Megjithatë, është njësoj e rëndësishme që t'i flasim zëshëm pengesat që i kemi, e jo që secila ngecje është rezultat i mospërpjekjes sonë. E them këtë vetëm për të qenë të sqarë me njëri-tjetrin në të gjitha veprimet tona", është shprehur Kurti, duke shtuar se nuk ka marrëveshje me Serbinë pa u zgjidhur çështja e të

zhdukurve me dhunë. "Po e rithem, që marrëveshje me Serbinë nuk ka pa u zgjidhur çështja e të zhdukurve me dhunë. Familjarët kanë kërkuar rifillimin e punimeve në Kizhevak, zbardhjen e fatit të prof. Ukshin Hotit dhe bisedimin për të dhënat e shumta për 16 vendvarrezat në lokacione të ndryshme brenda territorit të Serbisë. Kizhevaku e keni përcjellë edhe ju që është rifilluar dhe ka përfunduar", ka deklaruar Kurti.

Ndërsa puna e institucioneve të Republikës së Kosovës, sfidat dhe bashkëpunimi me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë gjatë vitit 2021, në proceset lidhur me zbardhjen e fatit të personave të zhdukur me forcë gjatë luftës në Kosovë, janë paraqitur nga Andin Hoti, kryesues i Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe kryetar i delegacionit për bisedime për çështjen e personave të zhdukur. "Gjatë vitit 2021 Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur, Instituti i Mjekësisë Ligjore, prokuroria, Policia e Kosovës dhe institucionet e tjera relevante, së bashku me shoqatat e familjarëve dhe partnerët ndërkombëtarë, janë angazhuar me përgjegjësi dhe përkushtim për hulumtimin, identifikimin dhe zgjidhjen e rasteve, duke insistuar njëkohësisht në dy parime themelore: dinamizimin dhe

humanizimin e procesit. Gjatë këtij viti është trajtuar me prioritet lokacioni i varrezës masive në Kizhevak të Serbisë. Gërmimet e filluara atje që në vitin 2015, pesë vjet më vonë kishin konfirmuar ekzistimin e varrezës masive me gjetjen e disa mbetjeve mortore në nëntor 2020. Gërmimet, që kanë përfunduar më 26 maj 2021, kanë rezultuar me gjetjen e mbetjeve mortore të 9 viktimave të luftës: shtatë identifikime të reja dhe dy raste ribashkimi me eshtrat e viktimave të zhvarrosura në lokacionin e Rudnicës, një varrezë tjetër masive në rajonin e Rashkës", ka thënë Hoti, duke shtuar se, pas identifikimit përmes analizës së ADN-së, është konfirmuar se mbetjet mortore iu përkasin viktimave të masakrës së Rezallës të kryer më 5 prill 1999. "Riatdhesimi i viktimave në Kosovë është bërë më 30 shtator, ndërsa u janë dorëzuar familjeve për rivarrim më 9 tetor. Përtej vështirësive dhe pengesave nga zvarritja e gërmimeve, gjetja e mbetjeve të dy personave në lokacione të ndryshme dëshmon, po ashtu, qasjen dhe tendencën e Serbisë për të fshehur dhe për t'i zhdukur gjurmët e krimit. Ndërsa në territorin e Republikës së Kosovës gjatë këtij viti janë kryer gërmimet në nëntë lokacione të ndryshme: varrezat në lagjen 'Brekoc' të Gjakovës, varrezat në lagjen 'Arbanë' të Prizrenit, varrezat e besimtarëve myslimanë

në veri të Mitrovicës, varrezat e qytetit në Shtime, varrezat në fshatin Petrovë të Shtimes, varrezat në fshatin Marinë të Skenderajt, një lokacion në fshatin Strellc të Deçanit, një lokacion në fshatin Planej të Prizrenit, si dhe lokacioni në fshatrat Dreth e Kalludër të Zubin Potokut, në dy prej të cilave janë gjetur dhe zhvarrosur mbetjet mortore të dy personave, një në Brekoc dhe një në Arbanë", ka thënë ai.

Kurse sa i përket hulumtimit të lokacioneve të dyshuara në Kosovë, gatishmëria e institucioneve, sipas Hotit, vazhdon të sfidohet në masë të madhe prej informatave jo të besueshme nga Serbia. "Megjithatë, tashmë janë lëshuar edhe pesë urdhëresa nga gjykata për gërmime në lokacione të ndryshme, për të cilat jemi në fazën e koordinimit për fillimin e punimeve", ka thënë Hoti.

## Krasniqi: Të përkushtohemi çdo ditë për avancimin e të drejtave të njeriut

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka vlerësuar se të drejtat dhe liritë e njeriut janë në bazamentin e shtetit të Kosovës. Në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, Krasniqi ka thënë se institucionet dhe gjithë shoqëria e Kosovës duhet të përkushtohen çdo ditë për avancimin e këtyre të drejtave. "Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe me të drejta të barabarta. Njësoj duhet që ta jetojnë tërë jetën e tyre. Ky është boshti i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut që u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 10

dhjetor 1948 e që njihet si Dita e të Drejtave të Njeriut. Në Kosovë, si një popull që ka vuajtur shumë gjatë mungesën e lirive themelore, arsimimin, lirinë e shprehjes, të punës e, madje, edhe të jetës, duhet të dimë më së miri që të njëjtat të mos ia mohojmë askujt. Të drejtat dhe liritë e njeriut janë në bazamentin e shtetit tonë dhe ne, të gjithë, pa dallim, institucione qendrore dhe lokale, si organizata, shoqëri e individë, duhet të përkushtohemi çdo ditë për avancimin e tyre", ka shkruar Krasniqi në llogarinë e vet në "Facebook".

Radiotelevizioni i Serbisë së bashku po prodhojnë një seri prej gjashtë dokumentarësh me titull: "Dosja e Kosovës" që trajton kronologjinë e ngjarjeve nga viti 1998 deri në vitin 2001.

Më herët edhe zyrtarë të tjerë të Serbisë kanë tentuar ta mohojnë këtë krim të tmerrshëm të forcave serbe. Një gjë të tillë e kishte bërë edhe ish-deputeti i Listës Serbe dhe ish-ministri i Administratës dhe Pushtetit Lokal (MAPL), Ivan Todosijeviq, por i cili ishte dënuar nga drejtësia e Kosovës. Dënimin prej dy vjetësh burgim Todosijeviqit ia kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit. Sipas vendimit të gjykatës, Todosijeviqi kishte kryer

veprën penale "nxitje e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik", kur kishte deklaruar, pos të tjerash, se "masakra e Reçakut ishte trillim" dhe se ishin "terroristët shqiptarë që e trilluan".

Në 21-vjetorin e masakrës së Reçakut, ish-shefi i misionit të OSBE-së në Kosovë, William Walker, pati thënë se gjenocidi që ka ndodhur në këtë fshat "nuk mund të mohohet nga askush". Walker është njeriu që doli publikisht më 1999 duke dhënë alarmin për krimet serbe në Kosovë.

Më 15 janar të vitit 1999 forcat policore dhe ushtarake serbe në Kosovë vranë 45 civilë shqiptarë në fshatin Reçak në komunën e Shtimes.





# Totaj: Po jetësojmë dëshirën e madhe të Thaçit dhe Veselit

PRIZREN, 10 DHJETOR (ER) - Shaqir Totaj edhe zyrtarisht ka marrë zyrtarisht detyrën e kryetarit të komunës së Prizrenit. Në një seancë solemne, Totaj ka dhënë betimin si kryetar i Prizrenit. Në këtë seancë kanë marrë pjesë përfaqësues të nivelit lokal dhe qendror në mesin e tyre edhe deputetë të Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së. Me këtë rast, Totaj ka falënderuar të gjithë qytetarët për mbështetjen e dhënë në zgjedhjet e fundit. Më tutje, ai ka thënë se janë duke

jetësuar dëshirën e madhe që kishin Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli për qytetin e Prizrenit. “Falënderoj të gjithë qytetarët pa dallim për mbështetjen dhe besimin për t’ia sjellë ndryshimin qytetit të bukur të Prizrenit. Sot ndiej emocion të veçantë sepse po jetësojmë dëshirën e madhe dhe kontributin e liderëve tanë historikë, Hashim Thaçi e Kadri Veseli, të cilët gjithmonë kanë kontribuar veçanërisht për Prizrenin”, ka thënë Totaj.



## MASHTI fton prindërit t’i vaksinonjë fëmijët mbi 12 vjeç



PRISHTINË, 10 DHJETOR (ER) - Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit (MASHTI) u ka bërë thirrje prindërve që ta shfrytëzojnë mundësinë për t’i vaksinuar fëmijët mbi 12 vjeç me vaksinën kundër Covidit. Në një konferencë për medie, zëvendësministrja e kësaj ministrie, Edona Maloku-Bërdyna, ka treguar edhe se si bëhet vaksinimi i fëmijëve mbi 12 vjeç. “Ajo që dimë në komunikim është se vaksinimi ka filluar dhe tani rekomandohet vaksinimi për fëmijët mbi 12 vjeç, dhe ka dy mënyra të vaksinimit. E para është përmes ekipeve mobile nëpër shkolla me aprovimin e prindërve apo kujdestarëve ligjorë të jepet aprovimi për vaksinim të fëmijëve dhe e dyta është që prindërit ta shfrytëzojnë këtë të drejtë në qendrat e vaksinimit. Unë do të doja të bëja një thirrje për të gjithë prindërit dhe kujdestarët ligjorë që t’i

shohin mundësitë e shfrytëzimit të tyre sepse kjo është në të mirë të gjithë neve që shëndeti publik të mirëmbahet meqenëse jemi në një pikë të mirë pandemike”, ka deklaruar Maloku-Bërdyna. Më tutje, ajo ka treguar edhe për mbarëvajtjen e procesit mësimor gjatë pandemisë. “Është fat i mirë që po shkojmë drejt përfundimit të pjesës së parë të këtij viti shkollor pa ndonjë problem të theksuar për sa i përket situatës me pandeminë. Bazuar në të dhënat e inspektoratit të arsimit, procesi arsimor në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar në Kosovë po vazhdon të zhvillohet në mënyrë të rregullt. Pra, sipas skenarit rikthimi, që nënkupton prani fizike në shkollë me orar të plotë. Në të njëjtën kohë, MASHTI ka vazhduar edhe mbështetjen financiare të nxënësve dhe të studentëve”, ka deklaruar ajo.

## Raporti 24-orësh i MSh-së: Një i vdekur, shtatë raste të reja me Covid dhe 3 991 të vaksinuar

PRISHTINË, 10 DHJETOR (ER) - Gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë ka ndërruar jetë një person nga Covidi dhe janë paraqitur shtatë raste të reja me koronavirus. Kështu ka bërë me dije Ministria e Shëndetësisë (MSh). Sipas kësaj ministrie, në 24 orët e

fundit janë dhënë 3 991 doza të vaksinës kundër Covid-19. “Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 640 380 doza të vaksinës. Deri më sot 770 941 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Nga 1 849 testime, 7 qytetarë kanë

rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit është shënuar 1 rast i vdekjes. Sot janë shënuar 9 qytetarë, kurse numri i përgjithshëm i të shënuarve është 157 863. Në total numri i rasteve aktive është 328”, ka njoftuar MSh-ja.





# Kurti për sanksionet e ShBA-së: Askush s'do të jetë më i fortë se shteti, u legjitimua aksioni i policisë

PRISHTINË, 10 DHJETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në mbledhjen e qeverisë, ka folur për sanksionet që Departamenti Amerikan i Thesarit ka ndërmarrë ndaj grupit të organizuar kriminal në veri të vendit. Kurti ka thënë se sanksionet e ShBA-së mbi këto grupe kanë legjitimuar aksionet që policia ka ndërmarrë kundër kontrabandës në veri të Mitrovicës. Ai ka shtuar se nuk do të lejojnë asnjë individ e asnjë grup që të jetë më i fortë se shteti e rendi demokratik. "Sanksionet e ShBA-së mbi këta individë e këto grupe kriminale treguan qartë adresat konkrete të vatrave të kriminalitetit që shtypin e shfrytëzojnë qytetarët e pjesës veriore dhe vërtetuan legjitimitetin e veprimeve të Policisë së Kosovës javë më parë në komunën Mitrovicës Veriore kundër kontrabanduesve të mallrave ilegale", ka thënë Kurti.

Më tutje, ai ka thënë se grupeve kriminale do t'i përgjigjen me luftë të përbashkët të institucioneve pa dallim etnie. "Lidhjeve të bashkëpunimit ndëretnik të grupeve kriminale dhe fushëveprimit të tyre transnacional ne do t'i përgjigjemi me luftë të përbashkët ndërmjet zyrtarëve të institucioneve tona pa dallim etnie dhe bashkëpunimit ndërkombëtar me aleatët tanë. Republika e Kosovës është e përcaktuar qartë në luftimin e krimit të organizuar në çdo pjesë të vendit", ka thënë Kurti, duke shtuar se për këta muaj të qeverisjes kanë dëshmuar se korrupsioni nuk mund të jetë i lidhur me nivelin e lartë politik. "Po theksoj edhe sot, po u dëshmuja e kundërta, masat do të jenë të menjëhershme, sepse toleranca ndaj korrupsionit në këtë qeveri është zero", ka thënë Kurti.



## Hoti: Sjellja e qeverisë ndaj sindikatave, e papranueshme



PRISHTINË, 10 DHJETOR (ER) - Ish-kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka bërë me dije se janë bërë nëntë muaj prej kur Projektligji i Pagave në sektorin publik nuk është sjellë në Kuvendin e Kosovës. Në llogarinë e vet në "Facebook", deputeti i LDK-së ka

shkruar se në vend të dialogut social me sindikata për të gjetur një zgjidhje të përbalueshme për buxhetin, qeveria Kurti ka zgjedhur tendencën për ndërhyrje në pavarësinë e organizimit sindikal në Kosovë. "Në anën tjetër, në vend të

dialogut social me sindikata për të gjetur një zgjidhje të përbalueshme për buxhetin dhe që do të ishte e pranueshme për të gjithë, ne po shohim konfrontime qeveri-sindikata dhe tendencë për ndërhyrje të qeverisë në pavarësinë e

organizimit sindikal në Kosovë", ka shkruar Hoti. Sipas tij, kjo sjellje e qeverisë në raport me sindikatat është e papranueshme. "Sindikatat janë institucione shoqërore të veçanta, të rregulluara dhe të mbrojtura me ligj. Ato kanë

bartur barrën e ndryshimeve shoqërore dhe politike në Kosovë në vitet më të vështira. Ato nuk janë vetëm organizata që mbrojnë interesat e punëtorëve që ato i përfaqësojnë. Është obligim shtetëror që sindikatat të jenë pjesë substanciale e konsultimeve për Ligjin e Pagave si dhe për shumë ligje dhe vendime të tjera shtetërore. Me këtë vonesë të procedimit në Kuvend të Ligjit për paga në sektorin publik dhe mosinteresim të qeverisë për t'i adresuar shqetësimet e sindikatave, me të drejtë deputetë të opozitës marrin nisma për ndarje të buxhetit për paga. Ne do ta diskutojmë më shumë kujdes amendamentin për ndarjen e mjeteve për paga në mbledhjen e grupit parlamentar të LDK-së përpara seancës së Kuvendit më 22 dhjetor, kur votohet buxheti në lexim të dytë", ka shkruar Hoti.

## Profesorët dhe mjekët në kategorinë e zyrtarëve publikë, të obliguar ta deklarojnë pasurinë

PRISHTINË, 10 DHJETOR (ER) - Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që mjekët dhe profesorët që punojnë në institucionet publike të futen në kategorinë e zyrtarëve publikë që duhet ta deklarojnë pasurinë. Ky

vendim ka ardhur me kërkesë të zëvendësministrit të Drejtësisë, Blerim Sallahu. "Ky projektligj parasheh disa risi që vijnë nga nevoja për t'i trajtuar deklarimet dhe të ardhurat e zyrtarëve

publikë. Është bërë një kategorizim për deklarim të pasurisë së tyre, ku përfshin gjyqtarët, mjekët që ushtrojnë detyrën e tyre dhe profesorët në universitetet publike", ka thënë Sallahu.





## OAK-u kërkon shkurtrimin e afatit kohor për inicimin e procedurës hetimore në AKK

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Në dëgjimin publik për Projektligjin për mbrojtjen e konkurrencës, Oda e Afarizmit e Kosovës (OAK) ka kërkuar shkurtrimin e afateve kohore për përgjigjen e inicimit të procedurës hetimore në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës (AKK).

Kryesuesi i grupit punues në Komisionin për Ekonomi, deputeti Armend Muja, ka thënë se ky projektligj adreson të gjitha format e mundshme të keqpërdorimit dhe abuzimit të bizneseve në treg. Megjithatë, Diellza Zeqiri, përfaqësuese e Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK), ka kërkuar ndryshimin e nenit 36, përkatësisht paragrafin 6 të këtij projektligji për shkurtrimin e afateve kohore për trajtimin e inicimit të procedurave për hetim nga

dhjetë muaj sa është aktualisht, në tre muaj.

“Në rast se inicion procedurë tek Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK), është një afat shumë i gjatë i pritjes, 10 muaj për të marrë në fund një konkluzion që nuk ka kushte për ta filluar procedurën. Mendojmë se është afat i gjatë. Ne kemi pasur raste konkrete. Si Odë e Afarizmit kemi paraqitur rastet në fillim të vitit tek Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, ndërsa deri në fund të vitit s’e kemi marrë as atë përgjigjen e kërkuar. Pas kësaj periudhe të gjatë të pritjes ne kemi marrë një përgjigje prej AKK-së që nuk ka kushte për ta vazhduar procedurën. Me të vërtetë është një afat shumë i gjatë”, ka thënë Zeqiri.

Kjo kërkesë e OAK-ut, kryesuesi



Muja ka thënë se duhet të harmonizohet me të drejtën administrative. “Edhe ashtu BE-ja na ka rekomanduar t’i harmonizojmë të gjitha ligjet me të drejtën administrative. Këtë ta harmonizojmë dhe pastaj, kur ka mungesë të kapaciteteve, shtetit i kërkojmë shtimin e kapaciteteve. Pra, e njësojmë

edhe këtë. Dhe do t’i sugjeroja administratës së Kuvendit në këtë pikë të njësohet me të drejtën administrative”, ka thënë Muja.

Ndërsa zyrtarë të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) kanë thënë se qëllimi i këtij projektligji është për mbrojtjen e konkurrencës

në treg. Rexhep Bllaca nga kjo ministri ka thënë se risi substanciale e këtij projektligji është trajtimi i abuzimit me pozitën dominuese. “Si risi substanciale e këtij projektligji është abuzimi me pozitën dominuese. Pozitë dominuese ka ndërmarrja e cila ka pjesëmarrje në treg 40 për qind, ndërsa nëse janë dy apo më shumë ndërmarrje që veprojnë bashkërisht në treg në mënyrë të ndërlidhur, pjesëmarrja në treg duhet të jetë 60 për qind. Kjo është në përputhje të plotë me Rregulloren e BE-së”, ka thënë Bllaca.

Edhe organizata të tjera për mbrojtjen e interesave të biznesit kanë kërkuar që me anë të këtij projektligji të rregullohet fusha e konkurrencës në tregun e Kosovës.

## Murati nënshkruan marrëveshje milionëshe me dy institucione bankare evropiane

PRISHTINË, 10 DHJETOR (ER) - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), Hekuran Murati, ka nënshkruar marrëveshje me Bankën Evropiane për Investime (BEI) dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në komunën e Mitrovicës.

Vlera e kësaj marrëveshjeje kap shifrën e 19.8 milionë euro dhe 13.5 milionë euro, respektivisht. “Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, së bashku me përfaqësuesit e



Bankës Evropiane për Investime (BEI), Matteo Rivellini dhe Cagin Pabucco, si

dhe me përfaqësuesin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), Matteo

Colangeli, kanë nënshkruar marrëveshjet financiare për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në komunën e Mitrovicës, në vlerë prej 19.8 milionë eurosh dhe 13.5 milionë euro, respektivisht”, ka njoftuar MFPT-ja.

Ky projekt, që bashkëfinancohet nga këto dy institucione bankare evropiane, do të shërbejë për rreth 213 mijë qytetarë të komunës së Mitrovicës. “Projekti që bashkëfinancohet nga këto dy institucione parashihet ndërtimin e impiantit për trajtimin e

ujërave të zeza dhe rehabilitimin e rrjetit ekzistues. Rreth 213 000 qytetarë të komunës së Mitrovicës pritet të përfitojnë nga ky projekt përmes përmirësimit të kushteve mjedisore dhe shëndetit publik. Zhvillimi i këtij projekti infrastrukturor do ta zvogëlojë ndotjen e mjedisit, veçanërisht në lumin Ibër. Projekti mbështetet edhe nga Bashkimi Evropian, me një grant prej 5 milionë eurosh përmes Kornizës Investuese për Ballkanin Perëndimor”, ka njoftuar MFPT-ja.

## Protestojnë punëtorët e KEK-ut, kërkojnë pagën e 13

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Sindikata e re e KEK-ut ka protestuar të premtën para ndërtesës së këtij institucioni në Prishtinë. Sindikalistët kanë kërkuar pagën e 13-të, sigurimin shëndetësor njëvjeçar, zbatimin e marrëveshjes kolektive, sigurimin e pajisjeve personale të mbrojtjes për punëtorë si dhe mjetet higjienike.

Rafet Osmani, kryetar i kësaj sindikate, ka thënë se asnjëherë nuk janë për protesta, mirëpo mosqasja e duhur e menaxhmentit ka bërë që ata të dalin në rrugë. “Qëllimi ynë nuk

ka qenë të protestojmë, mirëpo kërkojmë nga menaxhmenti të ulët e të bisedojë me ne”, ka thënë Osmani.

Ndërsa nënkryetari i Sindikatës së re të KEK-ut, Nexhat Llumnica, ka thënë se janë detyruar të dalin në protestë për shkak të injorancës së drejtorit menaxhues, duke e quajtur “mendjemadh”. Ai ka thënë se kërkesat i kanë të arsyeshme. “Duhet t’i tregojmë drejtorit menaxhues se përfaqësuesi sindikal nuk kërkon takim për t’u takuar me ta, por kërkon takim për t’i sqaruar kërkesat e



punëtorëve. 33 njerëz kanë vdekur ende pa dal në pension. E lusim Qeverinë e Kosovës që ta bëjë një listë të sëmundjeve profesionale. I kemi kërkesat

jashtëzakonisht të arsyeshme. Të gjitha kompanitë publike në Kosovë i kanë marrëveshjet kolektive në nivel të ndërmarrjes, ndërsa KEK-u nuk e ka këtë

marrëveshje. Andaj këtë menaxhment ne e quajmë mendjemadh”, ka thënë ai.

Ndërsa kryetari i BSPK-së, Atdhe Hykolli, ka thënë se i mbështet kërkesat e protestuesve të KEK-ut. “Pa ju Kosova është në terr e me ndihmën tuaj ne ecim përpara. Kërkoj nga menaxhmenti që të ulët sa më parë me sindikatën e të diskutoj për të drejtat e punëtorëve. Ne nuk kërkojmë as më shumë e as më pak sesa të drejtat elementare. Andaj edhe një herë BSPK-ja është në mbështetje të plotë në kërkesat tuaja”, ka thënë Hykolli.

## Meta kthen për rishqyrtim në Kuvend Ligjin për buxhetin 2022

Tiranë, 10 dhjetor - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, ka kthyer për rishqyrtim në Kuvend Ligjin për Buxhetin 2022. Sipas argumenteve të Metës, në tërësinë e tij ky buxhet

antisocial ka mangësi shqetësuese të transparencës në lidhje me shpenzimet dhe politikat fiskale, si dhe paraqet problematikë shumë shqetësuese në lidhje me nivelin e borxhit publik,

përdorimit dhe efektit ekonomik të tij. Për presidentin Meta, në buxhetin 2022 mungon mbështetja reale për sektorët e ekonomisë dhe në mënyrë të veçantë për bujqësinë, si

dhe mungon mbështetja e nevojshme buxhetore për shtresat në nevojë për kurimin ndaj infeksionit Covid-19, të cilët trajtohen në shtëpi dhe jashtë sistemit spitalor.





# Epoka e një mijë të vërtetave



## Nga Giovanbattista TREBISACCE

Xhorxh Oruell. Nëse shkrimtari britanik do të kishte jetuar më shumë se 47 vjet, ndoshta do ta kujtonim me më shumë ëndje por edhe mister për shkak të "profecive" të tij. Në fakt nuk ka pasur asgjë që ka lindur nga imagjinata e Oruell, dhe që nuk është vërtetuar në realitet. Mjafton të mendoni për romanin e tij "Viti 1984" (një lloj Big Brother bashkëkohor: Sot miliona e miliona kamera të shpërndara nëpër botë monitorojnë vazhdimisht lëvizjet tona) apo internetin dhe rrjetet sociale, ku kontrolli i vazhdueshëm kryhet nëpërmjet të ashtuquajturit "profilim". Apo "Fermën e Kafshëve", një përrallë alegorike madhështore, që mund të përfaqësojë sot retorikën "Të gjitha kafshët janë të barabarta", dhe e "demokracisë nga poshtë" nga njerëz që luftojnë kundër establishmentit, dhe që më pas bëhen establishmenti i radhës". Megjithatë, Oruell tregon një largpamësi

profetike, edhe në konsideratat e tij më të thella që synojnë të analizojnë marrëdhëniet e njeriut me të vërtetën. Reflektimet e tij denoncojnë me vendosmëri rreziqet e një të vërtete të deformuar, të prirur për të qenë në shërbim të propagandës, retorikës dhe nacionalizmit (tashmë e zëvendësuar nga sovraniteti), një e vërtetë e burgosur nga lajmet, e kushtëzuar në mos e asgjësuar nga kufijtë e lirisë së shprehjes.

Këto referenca janë shumë aktuale sot për shkak të shumë të vërtetave të disponueshme në ueb, të shumëfishuara në mënyrë eksponenciale dhe që megjithatë e bëjnë të duket bosh konceptin e vërtetësisë. Çdo gazetar, çdo faqe online, çdo faqe në Facebook, përhap të vërtetën e saj.

Faktet ngatërrohen me opinionet, lajmet e rreme vihen në qendër të vëmendjes duke e zhvendosur në periferi informacionin e saktë. Dhe clickbait (burimi i lajmeve sensacionale) shndërrohet në një linjë editoriale. Pra një "pyll i errët" për ata që kanë si të vetmen dëshirë informimin. Në këtë aspekt janë shumë

domethënëse fjalët e Papa Françeskut, të marra nga encilika e tij "Ungjilli i buzëqeshjes": "Çuditërisht, ne nuk kemi pasur kurrë më parë më shumë informacion se sa sot, e megjithatë vazhdojmë të mos e dimë se çfarë po ndodh".

Një ndryshim kursit në lidhje me parimet e shenjta të së drejtës për informim dhe i historiografisë, të cilat kanë qenë gjithmonë të lidhura me pluralizmin e lajmeve dhe burimet e tyre. I njëjti pluralizëm që garanton sot shumëfishimin e kanaleve të keqinformimit dhe që i jep mundësi lajmeve të rreme – të cilat vijnë nga rrjetet sociale apo rrjeti – të pushtojnë faqet e para edhe të mediave kryesore tradicionale.

Prandaj, nevojitet një "dietë informative" e karakterizuar nga një prirje e fortë për ndërveprim aktiv e mediave për të garantuar raportimin e së vërtetës. Dhe kjo gjë është e arritshme vetëm nëpërmjet një marrëdhënie të vazhdueshme me burimet e informacionit për të hetuar, verifikuar, krahasuar të dhënat, për të mos rënë viktima të keqinformimit.

Sot po përjetojmë një mbingarkesë informacioni, e cila sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, është një e keqe shumë më e madhe sesa pandemia e Covid-19: infodemia. Ky term i ri përfaqëson me saktësi dukurinë e ngopjes nga informacioni, zakonisht i pasaktë dhe i pa verifikuar, lajmet e rreme dhe sensacionalizmi, të cilat në këtë kohë pandemie kanë shkaktuar një rritje marramendëse të frikës dhe ankthit.

Të gjitha këtyre i shtojmë algoritmet matematikore ('zemra' e vërtetë e rrjeteve sociale dhe motorëve të kërkimit), të cilët përmes proceseve të profilizimit përzgjedhin lajmet që duhet të lexojmë, produktet që duhet të blejmë. Sipas një raporti mbi konsumin e informacionit nga Agcom (Autoriteti për Garancitë e Komunikimeve), 54.5 për qind e përdoruesve kanë qasje tek informacioni përmes rrjeteve sociale dhe motorëve të kërkimit.

Pra një proces që e ndryshon perceptimin tonë mbi realitetin, dhe që është konfiguruar në sytë tanë në

mënyrë të pjesshme dhe paragjyqese. E ardhmja e informacionit, nuk mund të injorojë një apel të fortë për përgjegjësi kolektive.

Lajmet nuk mund të shndërrohen në produkte të zakonshme, dhe gjigantët e teknologjisë duhet t'u nënshtrohen rregullave të qarta, të sakta dhe të patejkalueshme. Më pëlqen që ta mbyll këtë shkrim të shkurtër, duke përmendur një autor tjetër të madh të shekullit XX-të, Luixhi Pirandelo.

Ai thotë se nuk ka asnjë të vërtetë të vetme, por ka po aq të vërteta sa ka njerëz që besojnë se i zotërojnë ato. Në dramën "Kështu është", kur gruaja së zotit Ponza i kërkohet të zgjidhë misterin e identitetit të saj, gruaja, mishërimi i së vërtetës pirandeliane, me fytyrën e mbuluar nga një vello e zezë, përgjigjet se është njëherazi edhe vajza e zonjës Frola, po ashtu edhe gruaja e dytë e zotit Ponza: "Unë jam ajo që t'i beson se jam!".

*Shënim: Giovanbattista Trebisacce, profesor i pedagogjisë së përgjithshme në Universitetin e Katantias. / "Opinione.it" – Bota.al*




**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE 'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Nuhju dhe Krasniqi: Edhe ndaj Ulpianës i presim tri pikë

Trajneri Ardian Nuhju dhe futbollisti Albin Krasniqi kanë paralajmëruar se Drita do t'i kërkojë tri pikët e plota në ndeshjen e fundit të sezonit vjeshtor kundër Ulpianës. "Bëhet fjalë për një skuadër që realisht vendoset shumë mirë në fushë dhe ka ide se si të dalë në kundërsulm. Prandaj jemi munduar ta përgatitim ndeshjen në mënyrën më të mirë dhe skuadra është gati. Besoj se do ta vazhdojmë ecurinë pozitive dhe ta marrim maksimumin nga ndeshja ndaj Ulpianës", ka thënë Nuhju



dhe është në krizë të rezultateve, në anën tjetër Drenica e ka nisur mirë sezonin, por pas problemeve financiare tash zë vendin e gjashtë me 20 pikë. Dy ndeshjet e fundit për këtë sezon zhvillohen nesër (e diel), kurse përballen Ballkani - Gjilani dhe Malisheva - Dukagjini.

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 10 DHJETOR** - Skuadra e Dritës është përgatitur maksimalisht për ta regjistruar fitoren e tretë radhazi në BKT Superligën e Kosovës në futboll. Trajneri i kësaj skuadre, Ardian Nuhju, të premten në konferencë për media e ka lavdëruar kundërshtaren e radhës, Ulpianën, por ka bërë me dije se Drita synon fitoren e tretë radhazi në elitë. "Bëhet fjalë për një skuadër që realisht vendoset shumë mirë në fushë dhe ka ide se si të dalë në kundërsulm. Prandaj jemi munduar të përgatitim ndeshjen në mënyrën më të mirë dhe skuadra është gati. Besoj se do ta vazhdojmë

ecurinë pozitive dhe ta marrim maksimumin nga ndeshja ndaj Ulpianës", ka thënë Nuhju. "Skuadra nga ndeshja në ndeshje po përmirësohet. Po shohim se rezultatet pozitive po vijnë. Unë si trajner përqipem të punoj dhe do të kërkoj gjithmonë ta marr maksimumin. Me këtë skuadër që kemi asnjëherë nuk është mjaftueshëm, por i dimë edhe vështirësitë që na janë paraqitur në këta gjashtë muaj. Nga ndeshja në ndeshje jemi rritur dhe do të vazhdojmë kështu. Shpresoj që të shtunën ta mbyllim në mënyrën më të mirë", ka deklaruar Nuhju. Drita është e treta në tabelë, kurse pas humbjes në derbi nga Gjilani ka arritur ta mposhtë Dukagjinin me rezultat të thellë 4-0, më pas edhe të shënojë fitore

në derbin kundër Prishtinës (0-1). Në konferencë, krahas trajnerit Ardian Nuhju, ishte edhe futbollisti Albin Krasniqi. Ky i fundit ka deklaruar se Drita duhet të jetë e kujdesshme për faktin se Ulpiana ka ditur t'u nxjerrë telashe edhe skuadrave të para në tabelë. "E dimë se kundërshtari në ndeshjen e radhës është mjaft i fortë, sepse e dimë se Ulpiana u ka bërë problem edhe ekipeve të kreut të tabelës. Jemi të fokusuar, futemi maksimalisht të përgatitur, të bëjmë më të mirën dhe të arrijmë fitore, e cila do të ishte përmbyllja më e mirë për këtë stinor", ka thënë Krasniqi.

Ulpiana pozicionet në vendin e tetë me 18 pikë të grumbulluara, aq sa ka edhe Malisheva që renditet një pozitë më lart. Ndeshje interesante sot (e shtunë) do të zhvillohet edhe në mes të Llapit dhe Prishtinës. Këto dy skuadra kanë treguar formë të luhatshme në këtë sezon dhe synojnë që ta mbyllin me fitore. Aktualisht Llapi zë vendin e katërt me 26 pikë, derisa kampionët e Prishtinës pozicionohen një pozitë më poshtë me 24 pikë. Të shtunën zhvillohet edhe derbi i dy skuadrave nga regjioni i Drenicës, Feronikelit dhe Drenicës. "Nikli" është në vendin e fundit në tabelë

### BKT Superliga - Java e 18

**Të shtunën takohen:**  
13:00 Llapi - Prishtina  
13:00 Feronikeli - Drenica  
13:00 Drita - Ulpiana

**Të dielën takohen:**  
13:00 Malisheva - Dukagjini  
13:00 Ballkani - Gjilani

#### Tabela

1. Ballkani	33 pikë
2. Gjilani	32
3. Drita	31
4. Llapi	26
5. Prishtina	24
6. Drenica	20
7. Malisheva	18
8. Ulpiana	18
9. Dukagjini	17
10. Feronikeli	11

## Sot takohen Deçani - Vëllaznimi, nesër Rahoveci - Kastrioti



**DEÇAN, 10 DHJETOR** - Deçani - Vëllaznimi dhe Rahoveci - Kastrioti janë kryendeshjet e javës së 13-të të Superligës së Kosovës në hendboll në konkurrencë të meshkujve. Ndeshja në Deçan luhet të shtunën nga ora 19:00, ndërsa ajo në Rahovec të dielën

nga ora 18:00. Këto katër skuadra janë në garë për të zënë vend në Superligën A. Aktualisht Rahoveci është i katërti me 14 pikë. Kastrioti në vendin e pestë i ka 12 pikë, ndërsa Vëllaznimi është i gjashti me 10 pikë. Pak më mbrapa ka mbetur Deçani, që renditet i teti

me 6 pikë. Xhiroja e 13-të hapet të premten në ndeshjen Besa Famgas - Llapi. Ky takim nis në orën 18:30. Besa është favorite e madhe dhe nuk pritet të ketë telashe për t'i fituar dy pikë të reja. Favorite është edhe Prishtina ndaj Zhegrës, njëjtë si Trepça ndaj

Drenicës. Ndeshja në Prishtinë është të shtunën nga ora 14:30, kurse ajo në Mitrovicë të shtunën nga ora 18:00. Xhiroja e 14-t, e fundit për këtë vit, luhet të martën. Të mërkurën grumbullohet kombëtarja për ndeshjet miqësore me Kuvajtin.

## Stinori vjeshtor mbyllet me derbin Prishtina - Penza



**PRISHTINË, 10 DHJETOR** - Sot (e shtunë) do të zhvillohet xhiroja e dhjetë në Superligën e Femrave që është e fundit për stinorin vjeshtor. Derbi do të zhvillohet në mes të Prishtinës dhe Penzës, takim që zhvillohet të shtunën në kryeqytet. Vashat prishtinase kanë nëntë fitore në nëntë

ndeshje dhe do të tentojnë të mbeten të pamposhtura në elitë, kurse skuadra pejane synon fitoren dhe barazimin e pikëve në renditje. Këto dy skuadra u përballën edhe në Ligën Unike, ku fituan vashat pejane, ndërsa në Superligën e Femrave, skuadra prishtinase është e

vetmja që nuk di për humbje. Dy skuadrat kanë ambicie të mëdha për këtë edicion dhe kjo e bën përballjen edhe më interesante, sidomos kur shihet rivaliteti mes tyre në vitet e fundit. Penza ka tetë fitore dhe një humbje nga Prishtina. Në takimet e tjera të xhiros së dhjetë, Kastrioti do të

### SUPERLIGA e Femrave - Java 10

**Të shtunën takohen:**  
12:00 Kastrioti - Vëllaznimi  
14:00 Trepça - Bashkimi  
19:00 Prishtina - Penza

përballen me Vëllazninin dhe Trepça me Bashkimin.

## Gazetari spanjoll: Barça mund ta transferojë Januzajn

**BARCELONË, 10 DHJETOR** - Futbollisti shqiptar Adnan Januzaj mund të transferohet te Barcelona në muajin tjetër ose në afatin kalimtar të verës. Ansori me prejardhje nga Kosova është pjesë e Real Sociedadit që nga vera e vitit

2017 dhe ai tanimë është futur në vitin e fundit të kontratës me klubin bask. 26-vjeçari pëlqehet shumë nga trajneri i ri i Barcelonës, Xavi Hernandez dhe ai mund të transferohet në "Camp Nou". Lajmin e ka bërë me dije

gazetari spanjoll Lluís Canut, i cili ka thënë se Barcelona ka filluar ta vlerësojë seriozisht mundësinë e transferimit të Januzajt. Reprerentuesi i Belgjikës në verë mbetet lojtar i lirë por, sipas Canut, nuk

përrjashtohet që Barcelona ta tentojë transferimin e tij edhe në janar. Ish-futbollisti i Manchester Unitedit këtë edicion ka zhvilluar 22 ndeshje me Sociedadin, ku ka shënuar dy gola dhe ka asistuar në dy të tjerë.





## Bajrami: Ftesa nga Shqipëria? Vendosa me zemër

TIRANË, 10 DHJETOR - Nedim Bajrami është kthyer ta bëjë protagonistin tek Empoli, në sfidën e fundit, atë kundër Udineses, fantazisti kuqezi realizoi një gol dhe dhuroi një asistim. Në një intervistë për "La Gazzetta dello Sport",

Bajrami foli për disa tema, nga pozicioni i tij i pëlqyer në fushë, tek idhulli dhe deri te ftesa e marrë nga Shqipëria: "Preferoj të luaj si trekuartist, pas dy sulmuesve, por kam luajtur edhe në të majtë në skemën

4-3-3 te Zvicra. Luaj me të djathtë, por provoj shpesh ta përdor edhe të majtën. Idhulli? Ka qenë gjithnjë Zinedine Zidane. E pëlqej shumë kur isha te të rinjtë. Është pa diskutim modeli për t'u ndjekur. Ftesa nga

Shqipëria? Vendosa me zemër. Më thirrën dhe nuk u mendova për asnjë çast". Sipas medieve italiane, fantazisti kuqezi po ndiqet me interesim nga disa klube të ndryshme në Serinë A, mes të cilave edhe Napoli.



## Ndeshje interesante në Ligën Unike

Prishtinë, 10 dhjetor - Në fundjavë do të zhvillohet xhiroja e gjashtë në Ligën Unike. Rahoveci, pas fitores së parë xhiron e kaluar ndaj Vllaznisë, do të përballet me Kamza Basket, që ka dy fitore dhe tri humbje, dhe nëse Vreshtarët fitojnë, do të barazoheshin me pikë, apo Kamza do të ngjitet në tabelë. Tirana përballet me kampionin, Golden Eagle Yllin, ku therandasit janë favoritë për të fituar. Tiranasi kanë tri fitore dhe dy humbje, kurse Ylli katër fitore dhe një humbje, duke

### LIGA UNIKE - Java 6

**Të shtunën takohen:**  
17:00 Rahoveci - Kamza  
19:00 Tirana - Golden Eagle Ylli

**Të dielën takohen:**  
17:00 Prizreni 16 - Teuta  
19:00 Vllaznia - Peja



kryesuar i vetëm në renditje. Prizreni 16 dhe Teuta e Durrësit kanë nga tri fitore dhe dy humbje, andaj ballafaqimi i së dielës pritet të jetë interesant, ku dy skuadrat hyjnë për fitore. Java e gjashtë do të mbyllet me

duelin në mes të Vllaznisë dhe Pejës, skuadra që janë përballur më parë edhe në Ligën Ballkanike. Shkodranët kanë një fitore dhe katër humbje, kurse pejanët tri fitore dhe dy humbje në këtë edicion.

## Bien lakersat, Utah arrin fitoren e gjatë radhazi

MEMPHIS, 10 DHJETOR - Moment i artë për Utah Jazzin në NBA. Skuadra nga "Salt Lake City" mori fitoren e gjashtë radhazi pasi kaloi pa vështirësi me rezultatin 118-96 brenda në "Wells Fargo Center" të Philadelphia, 76ers duke konsoliduar pozitat në vendin e tretë të Konferencës së Perëndimit. Donovan Mitchell realizoi në total 22 pikë për Jazzin, ndërkohë që Rudy Gobert dhe kroati Bogdanović realizuan nga 17 dhe 14 pikë secili. Vazhdojnë luhatjet në këtë sezon për Los Angeles Lakersin i cili pësoi humbjen e 13-të sezonale pasi u mposht në Tennessee nga Memphis Grizzlies me shifrat 108-95. Triple-double i 100-të në karrierë i LeBron Jamesit nuk u mjaftoi kalifornianëve me mbretin që koleksionoi 20 pikë, 10 rebounde dhe 11 asistime. Te Memphisi Jaren Jacksoni shkëlqeu me 25 pikë, ndërsa Bane shtoi 23 pikë të tjera në këtë sukses. Për sa iu përket lakersave, Anthony Davis shënoi 22 pikë të tjera, ndërsa Russell Westbrook zhgënjëu



sërisht me vetëm 9 pikë në total. Një sukses me peshë mori edhe San Antonio Spursi që mposhti 123-111 Denver Nuggetsin duke regjistruar suksesin e 9-të sezonal. Serbi Nikola Jokić ishte fantastik duke

koleksionuar triple-double në radhës në karrierë pasi spikati me 22 pikë, 13 rebounde dhe 10 asistime gjithsesi të pamjaftueshme për ta shmangur humbjen e Nuggetsit.

### SHKURT

#### Xavi nxjerr në shitje tre lojtarë

Xavi Hernandez ka humbur durimin me skuadrën e tij, pas eliminimit nga Liga e Kampionëve. Barcelona është mposhtur për herë të dytë këtë sezon nga Bayerni, për ta humbur kështu kualifikimin tutje në atë kompeticion. Trajneri Xavi e sheh tashmë të pamundur të vazhdohet me këtë fond lojtarësh dhe qysh në janar do të nisë revolucionin. Sipas raportimeve të fundit nga Spanja, trajneri në fjalë ka dhënë dritën e gjelbër për shitjen e emrave si Ter Stegen, Frenkie de Jong e Serginho Dest. Bordi i Barcelonës thuhet se do të kërkojë rreth 30 milionë euro për kartonin e Dest, derisa për dy të tjerët nuk ka ende ndonjë shifër.

#### Covidi lë pasojë te Kimmichi

Mesfushori i Bayern Munchenit, Joshua Kimmich, do të mungojë deri në fund të vitit për shkak të një dëmtimi të mushkërive nga koronavirusi. Reprerentuesi gjerman rezultoi pozitiv me Covid-19 dy javë më parë dhe nuk ka marrë pjesë në lojën e ekipit që nga 6 nëntori. Klubi ka njoftuar se ai mbetet i paafte të stërvitet dhe nuk do të luajë më në vitin 2021. Kimmich tregoi në tetor se ai nuk e kishte marrë ende vaksinën kundër Covidit, duke përmendur shqetësimet për mungesën e studimeve afatgjata në vaksinat, raporton "Eurosport". Bayern Munich ka edhe tri ndeshje të tjera para fundit të vitit, duke e mbyllur 2021-n kundër Wolfsburgut të premtën më 17 dhjetor para pushimit dimëror të Bundesligës. Skuadra e Nagelsmann gjithashtu kryeson Bundesligën pas 14 ndeshjeve.

#### Sarri: Shpresoj të luajmë kundër Barcelonës

Ndeshja me Galatasarayn vërtetoi përfundimisht kalimin e Lazios në "play-off"-in e Ligës së Evropës. Një barazim në ndeshjen e fundit të skuadrës romake në vendin e dytë në grup dhe turqit si liderë. Dhe kështu "Biancocelesti" do të duhet të përballet me një skuadër të lartë, të braktisur nga Liga e Kampionëve, në "play-off". Sarri, në konferencën për shtyp pas ndeshjes, pranoi me buzëqeshje: "Shpresoj të luajmë kundër Barcelonës. Nuk kam luajtur kurrë. Do të ishte ideale në finale. Nuk do të doja të takohesha me Sherifin, as nuk e di ku luan. Mendoj se është një udhëtim i komplikuar".

#### Mascherano do të emërohet trajner i Argentinës U20

Ish-futbollisti i Barcelonës dhe Liverpoolit, Javier Mascherano, do të emërohet trajner i Kombëtares së Argentinës U20. Mascherano u pensionua në vitin e kaluar nga futbollit i luajtur në moshën 36-vjeçare dhe tashmë do t'i hyjë zezes së trajnerit. 37-vjeçari do ta marrë detyrën e trajnerit të skuadrës U-20 të Argentinës vitin e ardhshëm, ka konfirmuar të enjten Federata Argentinase e Futbollit (AFA). Ish-mesfushori i njohur do ta zëvendësojë trajnerin aktual Fernando Batista, i cili lë rolin për t'iu bashkuar stafit të trajnerit të sapoemëruar të Venezuelës, Jose Pekerman.

#### Serena Williams: Ja pse u tërhoqa nga Australian Open

Tenistja amerikane Serena Williams ka vendosur të mos luajë në grand slam e Australian Open, që nis më 17 janar në Melburn. Ajo e ka fituar shtatë herë këtë turme dhe mungesa e saj është një "minus" i madh për organizatorët. Në një intervistë për mediet amerikane, "pantera e zezë" ka sqaruar mungesën e saj. "Ndoqa udhëzimet e stafit tim mjekësor, që më këshilloi të qëndroj edhe pak kohë pushim. Nuk duhet të nxitohem dhe rikthehem më herët në fushë. Për këtë arsye vendosa të mos luaj në Australian Open", ka thënë Serena Williams. "Nuk ishte e lehtë të merrja këtë vendim, por e ndiej edhe vetë që fizikisht nuk jam në formën time më të mirë. Melburn është një qytet i dashur për mua, ndaj do të më mungojnë fansat, por shpresoj të rikthehem sa më shpejt në nivelet e larta", ka deklaruar Williams. Këtë vit tenistja amerikane ka luajtur vetëm në 6 turne dhe nuk luan që prej Wimbledonit. Me shumë gjasë objektivi i saj do të jetë grand slami i Roland Garros.



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE  
NPL PËRPARIMI SH.A 1 - VUSHTRRI  
Nr: Protokolit: 267/21  
Data: 09.12.2021

**Ndërmarrja Publike Lokale NPL "Përparimi" Sh.A-Vushtrri**

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), bazuar në nenin 4, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 7/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik. Ndërmarrja Publike Lokale "Përparimi" SH.A në Vushtrri shpall:

**KONKURS**  
Për plotësimin e vendeve të lira të punës:

**Titulli:** Sigurim fizik-roje

**Numri i ekzekutuesve:** 2 (dy)  
**Orët e punës:** 40 në javë  
**Kohëzgjatja:** Me kohë të caktuar 1 vitë (një vitë) me mundësi vazhdimi, punë provuese 6 muaj

**Kushtet , aftësitë dhe njohuritë e kërkuara:**

- CV-në
- Të ketë Diplomë të shkollës së Mesme,
- Aftësi organizative, planifikuese dhe kordinuese
- Të prezantoj letërnjoftimin;
- Certifikatë nga Gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 3 muaj);
- Certifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

**Kushtet e veçanta:**

- Shkathësi fizike
- Aftësi të mira komunikuese

**Koeficienti i pagës:** sipas akteve të brendshëm të Ndërmarrjes

**Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:**

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryejë detyrat e punës.
- Përkujdeset mbi sigurimin e objektit dhe pasurisë të organizatës, institucionit publik.
- Në rast të ndonjë rreziku lajmëron menjëherë personat kompetent-mbikëqyrësin e sigurimit.
- Sipas nevojës mund të caktohet edhe në lokacion tjetër për sigurim fizik.
- Është i obliguar të përdorë të gjitha mjetet e parapara të mbrojtjes në punë.
- Të jetë i aftë që të përdor mjetet kundër zjarrit.
- Për punën që kryen i përgjigjet mbikëqyrësit të sigurimit.

Aplikacionin së bashku me diplomën, CV etj. Mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në NPL "Përparimi" Sh.A në Vushtrri, rruga Gjergj Kastrioti Skenderbeu nr.82, nga ora 8:00-16:00h

Konkursi do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 10.12.2021 deri më datën 24.12.2021. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues.

Ndërmarrja Publike Lokale "Përparimi" SH.A në Vushtrri ofron mundësin të barabartë punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të të gjitha komuniteteve.

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE  
NPL PËRPARIMI SH.A 1 - VUSHTRRI  
Nr: Protokolit: 266/21  
Data: 09.12.2021

Lokalno Javno Preduzeće NPL "Përparimi" A.D - Vučitrn

Na osnovu člana 7 i 8 Zakona o radu (Zakon br. 03L / 212), I bazirajući na Administrativnog uputstva br. 07/2017, zkon 4 i 5 o regulisanju postupaka konkursa u javnom sektoru. Lokalno Javno Preduzeće "Përparimi" A.D u Vučitrnu objavljuje:

**Konkurs i unutrasni**  
Za popunjavanje upražnjenoj mjesto:

**Naziv:** Šef jedinice fizičkog obezbeđenja u NPL "Përparimi" A.D  
**Stručna sprema:** Srednja škole ili Fakultetska diploma  
**Radni staž:** 1 godina najmanje sličan rad u bilo kojoj drugoj instituciji  
**Br. izvršilaca:** (1) Jedan  
**Koeficijenti:**  
**Posebni uslovi:**

- Sposobnost rada u timu, pod pritiskom i da svedoči fleksibilnosti na poslu;
- Dobre veštine timskog rada kao i dobre komunikacijske veštine.

**Dužnosti i odgovornosti:**

- Vodi evidenciju službe fizičkog obezbeđenja.
- Koordinira rad između glavnog izvršnog direktora i osoblja fizičkog obezbeđenja.
- Obezbeđuje redovno funkcionisanje i efektivno pružanje usluga fizičkog obezbeđenja u svim zgradama.
- Osigurava da radnici fizičkog obezbeđenja obavljaju svoje dužnosti u skladu sa potrebnim pravilima i standardima.
- Sastavlja registar radnog vremena radnika fizičkog obezbeđenja, ažurira i reprogramira raspored radi pokrivanja odsustva kada je to potrebno.
- Osigurava i kontrolise efektivnu i ekonomičnu upotrebu radne imovine.
- Izrađuje izveštaje o obavljenim poslovima u okviru jedinice fizičkog obezbeđenja.
- Odgovoran glavnom izvršnom službeniku za svoj rad

Aplikacija zajedno sa diplomom, CV, itd. Mogu se dostaviti u Arhivu, u NPL "Përparimi" A.D u Vučitrnu, ulica Gjergj Kastrioti Skenderbeu br.82, od 8:00-16:00h

Konkurs će biti otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja u dnevnom novinama od 24.11.2021. do 08.12.2021. Zahtjevi dostavljeni nakon roka i nepotpuni sa relevantnom dokumentacijom neće se razmatrati od strane Komisije za ocjenjivanje.

Lokalno Javno Preduzeće „Përparimi“ A.D u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo svih zajednica.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook [www.facebook.com/gjejpuneshpejte](https://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

**RESTAURANT**

**SWISS**

**TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Demir Zeqiri shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike të shkollës "Mithat Frashëri" Istog.
- Burim Qaushi Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesën e SH.M.U. "Dy Dëshmorët " në fshatin Sheremet KK Gjakovë.
- Nasuf Kurtaj shpall te pavlefshme dy dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren .
- Safet Guraziu shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.
- EDG O.P me numër te regjistrimit te biznesit: 70557819 me adrese Prishtinë, Holger Pedersen Nr.11 shpalli te pavlefshme certifikatën e regjistrimit e leshura nga ARBK.
- Blerim Nue Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl. IV të SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Mirlind Rama shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

